

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **1909466981031194-26-2625-2-3-6**

Sa i përket tenderit për **Sigurimi i Automjeteve Zyrtare**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	KOMPANIA E SIGURIMEVE " PRISIG " SH.A.
NUI	601173371
Adresa	Rr.Eduard Lir, Ob.2-Lagj.Arbëria
Vendi	PRISHTINË
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	038 221 000
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Besarb Blakaj
Adresa elektronike	tenders@prisig-ks.com
Data e parashtrimit të ankesës	06.08.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Sigurimi i Automjeteve Zyrtare

Ne Kompania e Sigurimeve Prisig Sh.a, kemi marr pjese ne aktivitetin e prokurimit me titull: Sigurimi i Automjeteve Zyrtare dhe me nr. te prokurimit: 1909466981031194-26-2625-2-3-6, pas njoftimit per vendim te AK te dates 05.05.2026, ku ne PRISIG SH.A jemi shpallur ofertues te passukseshem nga aktiviteti I ketij Prokurimi ndersa OE Link Insurance Brokers eshte shpallur fitues, kur ne fakt ky OE ishte dashur te eleminohen nga ky aktivitet I prokurimit, kemi qene te obliguar qe te bejme kerkese per rishqyrtim pasi qe e shohim te arsyeshme duke u bazuar ne LPP. Edhe pas ankeses sone te bere ne AK, na eshte refuzuar kerkesa si e pabazuar e cila na ka obliguar te drejtohem ne instance me te larta, pasi qe jemi ne te drejten tone. Me daten 14.05.2026 kemi dorezuar ankesen tone prane OSHP-se ku me daten 29.05.2026 eksperti I OSHP-se ka konstatuar se “Ankesa e OE ankues te aprovohet si e bazuar”. Ndersa me daten 24.06.2026 kemi pranuar edhe vendimin e OSHP-se, ku ankesa jone eshte aprovuar si e bazuar duke ju referuar fakteve dhe provave te percjellur nga ana e jone, gjithashtu gjene shkelje nga ana e AK tek neni 7, 59 dhe 60 te LPP si dhe te neni 40 te RrPP. Me daten 29.07.2026 kemi pranuar Vendimin e AK, ku AK prap e ka shpallur fitues OE Link Insurance Broker SH.P.K. Me daten 30.07.2026 kemi kerkuar qasje ne dokumentacion. Me daten 31.07.2026 kemi dorezuar kerkesen tone per rishqyrtim duke forcuar edhe me tej argumentet e tona ndersa me daten 04.08.2026 kemi pranuar vendimin mbi refuzimin e kerkeses sone nga ana e autoritetit kontraktues. Me qrast detyrohemi prap te ju drejtohem juve si OSHP.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Njoftimi për kontratë: 22.04.2026

Takimi për hapjen e tenderëve: 28.04.2026

Procesverbali i hapjes së tenderëve : 28.04.2026

Njoftimi për vendimin e AK : 05.05.2026

Kërkesa për rishqyrtim: 06.05.2026

Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim: 07.05.2026

Dorezimi I ankesës në OSHP: 14.05.2026

Pranimi I raportit të ekspertit të OSHP: 29.05.2026

Pranimi I VENDIMIT të OSHP: 24.06.2026

Njoftimi për vendimin e AK: 29.07.2026

Kërkesë për qasje në dokumentacion: 30.07.2026

Kërkesa për rishqyrtim: 31.07.2026

Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim: 04.08.2026

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjërë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkelje e nenit 1 të LPP-së (Qëllimi)

Shkelje e nenit 7 të LPP-së (Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi)

Shkelje e nenit 56 të LPP-se (Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave)

Shkelje e nenit 59 të LPP-së (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve)

Shkelje e nenit 60 të LPP-së (Kriteret për Dhënien e Kontratës).

Shkelje e nenit 40 të RRPP (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve)

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Shkeljet e evidentuara:

Shkelja e kritereve të përcaktuara në dosjen e tenderit, ku sipas kërkesave të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues, operatorët ekonomik duhet të plotësojnë, ndër të tjera, kriterin si vijon: Kërkesat e përshtatshmërisë Profesionale; **c. “Operatori Ekonomik duhet të jetë i certifikuar apo licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës si kompani për ofrimin e shërbimeve të sigurimeve.”**

Në këtë kontekst, theksojmë se operatori ekonomik i shpallur fitues posedon licencë për ndërmjetësim në sigurime (broker), **e cila e autorizon atë vetëm për ndërmjetësim në sigurime Jo-Jetë dhe jo për ofrim të drejtpërdrejtë të sigurimeve**, citojme licencën e lëshuar nga BQK, “Institucioni Financiar I lartpërmendur autorizohet të kryej veprimtari të ndërmjetësimit në Sigurime Jo Jetë ne territorin e Republikës së Kosovës.

Në bazë të kornizës ligjore dhe rregullative të Banka Qendrore e Kosovës, ekziston dallim i qartë ndërmjet: Kompanive të sigurimit, të cilat janë të autorizuar të ofrojnë produkte sigurimi dhe të marrin përsipër rrezikun, dhe Brokerëve të sigurimeve, të cilët vetëm ndërmjetësojnë ndërmjet klientit dhe kompanive të sigurimit.

Pra, një broker nuk mund të konsiderohet si “kompani për ofrimin e shërbimeve të sigurimeve” në kuptimin e kërkesave të dosjes së tenderit.

Në sektorin e sigurimeve kjo bëhet shumë e rëndësishme: Kompania e sigurimit ofron shërbime sigurimi ndërsa Brokeri ose agjenti bën ndërmjetësim në sigurime.

(chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://bqk-kos.org/wp-content/uploads/2024/11/Ligji-Nr.-05-L-045-per-Sigurimet.pdf) - Ligjin Nr. 05/L-045 për Sigurimet

Ligjin Nr. 05/L-045 për Sigurimet, Ligji jep përkufizime të ndara për:

Kompaninë e sigurimeve (siguruesin);
Brokerin e sigurimeve;
Agjentin e sigurimeve.

Sipas Ligjit për Sigurimet dhe rregulloreve të BQK-së:

- kompania e sigurimeve merr përsipër rrezikun;
- kompania e sigurimeve lëshon policën;
- kompania e sigurimeve paguan dëmet.

Ndërsa brokeri:

- ndërmjetëson;

- këshillon klientin;
- negocion me siguruesit;
- nuk merr përsipër rrezikun e sigurimit;
- nuk mund të lëshojë policë në emrin e vet.

Ekziston një dallim thelbësor dhe substancial ndërmjet një kompanie për ofrimin e shërbimeve të sigurimeve dhe një ndërmjetësi (brokeri) të sigurimeve.

Neni 110 Ndërmjetësuesit në sigurime

1. “Ndërmjetësues në sigurime nënkupton personin fizik apo juridik i licencuar nga BQK-ja dhe i **“kontraktuar nga siguruesi”**, për të ushtruar veprimtari të ndërmjetësimit në sigurime. në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni. (OE nuk ka paraqitur ndonje kontrate me ndonje sigurues për “ndërmjetësim” të sigurimeve).

2. Ndërmjetësimi në sigurime është veprimtaria e prezantimit, propozimit dhe kryerjes së aktiviteteve të tjera përgatitore, deri në nënshkrimin e kontratës së sigurimit, si dhe dhënien e asistencës gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës, veçanërisht në rast dëmi. Ndërmjetësuesit në sigurime ndahen në dy kategori, varësisht nga fakti nëse ata veprojnë kryesisht në llogari të siguruesve apo në llogari të të siguruarve:

2.1. kur ndërmjetësuesi vepron kryesisht në llogari të siguruesve, ata njihen si agjentë;

2.2. kur ndërmjetësi vepron kryesisht në llogari të të **siguruarve**, ata njihen si **broker** dhe janë të **pavarur nga siguruesit**, produktet e të cilëve i shet. (Si është e mundur që një broker të negociojë se pari me autoritetin dhe pastaj I duhet të negociojë me siguruesin, kur nuk është I kontraktuar nga siguruesi për këto aktivitete të prokurimit).

Ne këtu kemi konflikt për vetë faktin se kemi një broker që ka ofertuar së bashku me 3 kompani të tjera ofertuese që e I kanë tarifat e njëjta.

Kompania e sigurimeve është subjekti juridik i licencuar nga BQK për të ushtruar veprimtarinë e sigurimit. Ajo merr përsipër rrezikun e sigurimit, lidh kontratën e sigurimit në cilësinë e siguruesit, lëshon policën e sigurimit, arkëton primin dhe mban përgjegjësi kontraktore e financiare për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata, përfshirë pagesën e dëmeve. Në këtë marrëdhënie juridike, kompania e sigurimeve është palë kontraktuese dhe bartëse e të drejtave dhe detyrimeve që burojnë nga kontrata e sigurimit.

Ndërmjetësi (brokeri) i sigurimeve, në anën tjetër, nuk ushtron veprimtarinë e sigurimit, por veprimtarinë e ndërmjetësimit në sigurime. Roli i tij kufizohet në identifikimin e nevojave të klientit, këshillimin profesional, prezantimin e ofertave të siguruesve dhe ndërmjetësimin për lidhjen e kontratës ndërmjet klientit dhe kompanisë së sigurimeve. Brokeri nuk merr përsipër rrezikun e sigurimit, nuk është sigurues, nuk lëshon policë në emrin e vet dhe nuk mban përgjegjësi për pagesën e dëmeve që rrjedhin nga kontrata e sigurimit.

Vetë kuptimi gjuhësor i termit "ndërmjetësim" nënkupton veprimin e një personi ose

subjekti që qëndron ndërmjet dy palëve për të mundësuar lidhjen e një marrëveshjeje, pa qenë vetë pala që ofron shërbimin ose produktin përfundimtar. Për rrjedhojë, ndërmjetësi nuk mund të identifikohet me ofruesin e shërbimit që ndërmjetëson.

Pikërisht për këtë arsye, edhe legjislacioni i BQK-së i trajton këto si dy veprimtari të ndryshme dhe i licencon me baza të ndryshme ligjore: një licencë për ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit dhe një licencë tjetër për ushtrimin e veprimtarisë së ndërmjetësimit në sigurime. Nëse këto dy veprimtari do të ishin të njëjta, nuk do të ekzistonte nevoja që ligji dhe BQK të parashihnin kategori të veçanta licencimi.

Për këtë arsye, kriteri i tenderit, i cili kërkon që operatori ekonomik të jetë "i Certifikuar apo Licencuar nga BQK si Kompani për ofrimin e shërbimeve të sigurimeve", nuk mund të interpretohet si kriter që përfshin edhe subjektet e licencuara vetëm për ndërmjetësim në sigurime. Një interpretim i tillë do të ndryshonte përmbajtjen e kriterit të vendosur nga vetë Autoriteti Kontraktues dhe do t'i barazonte padrejtësisht dy veprimtari të ndryshme, të cilat legjislacioni i trajton si kategori të veçanta juridike.

Bazuar në Certifikaten e Licensës së Kompanisë së Brokerimit Nr. NS – 012, DATA 12 PRILL 2022, lëshuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës SH.P.K. me numër të regjistrimit të biznesit: 811310185, Institucioni financiar i lartpërmendur autorizohet të kryej veprimtari të ndërmjetësimit të sigurimeve Jo Jetë ne territorin e Republikës së Kosovës.

Në këtë rast kemi Cenim të parimeve të barazisë dhe transparencës, pasi që pranimi i një operatori ekonomik që nuk plotëson kriteret themelore të përcaktuara në dosjen e tenderit, *përbën shkelje të parimit të trajtimit të barabartë, cenim të transparencës në procedurë dhe devijim nga kushtet e shpallura paraprakisht.*

Ky veprim i Ndërmarrjes Publike Banesore SH.A. për shpalljen fitues të Link Insurance Brokers shpk, ***bie ndesh me nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik, i cili garanton trajtim të barabartë dhe transparencë, si dhe me nenet 56 dhe 59 të po këtij ligji, të cilat obligojnë Autoritetin Kontraktues të sigurojë që operatorët ekonomik të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë profesionale dhe që vlerësimi të bëhet vetëm mbi ofertat e përgjegjshme.***

Po ashtu, në përputhje me KORNIZËN RREGULLATIVE TË BANKËS QENDRORE TË KOSOVËS, ekziston dallim i qartë ndërmjet kompanive të sigurimit dhe brokerëve të sigurimeve, ku këta të fundit nuk janë të autorizuar për ofrim të drejtpërdrejtë të sigurimeve."

Si shembull që do të duhej të merrej parasysh është se: cka nese kompanit e sigurimeve vendosin te mos ta perkrahin me Sigurime kete Broker, pasi qe po dihet qe nje broker mund vetem te ndermjetesoj Sigurime dhe assesi te leshoj polica te sigurimeve, atehere do te mbetej pa sigurime edhe AK qe rrjedhimisht do te shkaktonte humbje financiare ne

anulimin dhe ne hapjen e procedures se re te kontrates per te njejtin aktivitet.

Një tjetër pyetje te cilen AK do të duhej ta merrte në konsideratë është edhe “në cilat tarifa të sigurimit të autopërgjegjësisë është bazuar Link Insurance Broker?”. A ka marre autorizim nga ndonje kompani e sigurimeve per te ofertuar me tarifat e kompanive te sigurimit?

Brokeri juridikisht nuk i krijon vetë tarifat e sigurimit TPL, sepse tarifat e TPL zakonisht janë të unifikuara dhe të përcaktuara sipas rregullave të tregut dhe akteve të Banka Qendrore e Republikës së Kosovës. Në rastin konkret paraqitet një paqartësi serioze lidhur me mënyrën e formimit të ofertës nga operatori ekonomik "Link Broker", pasi në këtë procedurë kanë marrë pjesë edhe vetë kompanitë e licencuara të sigurimeve, të cilat janë bartëse të drejtpërdrejta të rrezikut dhe ofruese të produkteve të sigurimit. Nga gjithsej 10 kompani të sigurimeve të licencuara në Republikën e Kosovës, 7 prej tyre kanë marrë pjesë në këtë aktivitet të prokurimit si operatorë ekonomikë. Bazuar ne tarifat e kompanive te sigurimeve te aprovuara nga BQK te kategoria “Grupi Tarifor IV – Traktoret me rexhistrim te detyrueshem”, klafisikimi 73-110KW, ndryshon cmimi varësisht nga kompania e sigurimeve. Link Insurance Broker, si broker nuk ka tarifa te veta per sigurimet TPL, ndersa te automjeti me nr rendor 32. Case 580 ST, ka ofertuar me cmim 59.00€, derisa pjesemarrrese ne tender kemi qene edhe ne Prisig, Scardian dhe Illyria te cilat e kemi cmimin 59.00€ per kete kategori te automjetit, prandaj nuk eshte e qarte se nga e ka marre kete cmim Link Insurance Broker, si mund te ofertoje cmime me tarfiat e kompanive te tjera. Në këto rrethana shtrohet pyetja se mbi çfarë baze një ndërmjetësues i sigurimeve (broker) ka mundur të ofrojë të njëjtën tarifë, kur vetë kompanitë e sigurimeve që posedojnë licencën për ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit kanë qenë pjesëmarrëse në këtë procedurë.

Për më tepër, **brokeri nuk posedon tarifa autonome të sigurimit TPL**, pasi çmimet e ofruara prej tij varen tërësisht nga çmimoret dhe autorizimet e kompanive të sigurimit të licencuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës. Kjo dëshmon se brokeri nuk është ofrues real i sigurimit, por vetëm ndërmjetësues i ofertave të siguruesve të tjerë. Për rrjedhojë, licenca për ndërmjetësim nuk mund të konsiderohet e barasvlershme me licencën për ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit, pasi brokeri nuk ka kompetencë ligjore të krijojë, tarifoje apo ofrojë produkt sigurimi në mënyrë të pavarur. Brokeri, si ndërmjetësues në sigurime, nuk ka tarifa të veta për sigurime, nuk e përcakton primin e sigurimit dhe nuk e merr përsipër rrezikun e sigurimit. Çdo ofertë e tij duhet të mbështetet në produktin, kushtet dhe tarifat e një kompanie konkrete të sigurimeve.

Edhe në rast se Autoriteti Kontraktues do të pranonte ofertën e një ndërmjetësuesi të sigurimeve (brokerit), duhet të merret parasysh se marrëdhënia juridike që krijohet për realizimin e shërbimit të sigurimit nuk do të jetë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe brokerit si ofrues i sigurimit.

Në fakt, çdo policë sigurimi do të lëshohet nga një kompani e sigurimeve e licencuar nga BQK, e cila është bartëse e rrezikut të sigurimit dhe subjekti që merr përsipër detyrimet që burojnë nga kontrata e sigurimit, përfshirë trajtimin dhe pagesën e dëmeve.

Brokëri, në këtë marrëdhënie, do të ketë vetëm rolin e ndërmjetësuesit, duke vepruar si lidhës ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe kompanisë së sigurimeve, pa qenë vetë sigurues dhe pa mbajtur përgjegjësi për mbulimin e rrezikut të siguruar.

Për rrjedhojë, pranimi i një brokeri si operator ekonomik për ofrimin e shërbimeve të sigurimit krijon një mospërputhje ndërmjet subjektit që shpallet fitues dhe subjektit që në realitet do të ofrojë dhe realizojë shërbimin e kërkuar. Kjo dëshmon se brokeri nuk është ofruesi i drejtpërdrejtë i shërbimit të sigurimit, por vetëm ndërmjetësues në realizimin e tij.

Ne refuzimin e kërkesës sone për rishqyrtim të datës 07.05.2026, në lidhje me Kriterin e pershtatshmerisë profesionale “Operatori Ekonomik duhet të jetë i certifikuar apo licencuar nga BQK si kompani për ofrimin e shërbimeve të sigurimeve” “Certifikata ose Licenca valide nga BQK përmes së cilës autorizohet që kompania të kryej shërbime sigurimesh në territorin e Republikës së Kosovës”, AK është leshuar në perkufizime duke u munduar ta zgjerojë në mënyrë të padrejte kriterin të cilin vetë e ka vendosur, ndërsa neve na drejtohet duke thënë që interpretimi jonë është i ngushtë dhe i pambeshtetshëm në tekstin e kriterit, duke u munduar të japim kinse kufizime, përderisa ne vetëm po kërkojmë të drejtën tonë bazuar në kriterin e vendosur vetë nga AK.

Pavarësisht kësaj, AK ka tentuar ta interpretoj kriterin në mënyrë të zgjeruar dhe jashtë kuptimit të tij logjik e profesional, vetëm pas përfundimit të vlerësimit të ofertave, me qëllim të arsyetimit të shpalljes së një brokeri si operator i përgjegjshëm. Një interpretim i tillë është i papranueshëm dhe bie ndesh me parimet bazë të transparencës dhe trajtimit të barabartë në prokurim publik. Të gjitha këto ankesa që ne i kemi bërë atëherë tek AK, i kemi paraqitur edhe në OSHP me datën 14.05.2026, ku vetë PSH i OSHP e ka cilesuar se **“PSH konstaton se kërkesat e parashtruara në DT janë obligative dhe detyruese për të gjithë pjesëmarrësit në procedurë, përfshirë edhe vetë Autoritetin Kontraktues. Rrjedhimisht PSH thekson se këto kërkesa duhet të zbatohen dhe të përmbushen në përputhje të plotë dhe nuk mund të ndryshohen apo të zgjerohen pas hapjes së ofertave dhe gjatë fazës së vlerësimit”** si dhe **“Bazuar në të gjitha provat dhe faktet e administruara, Paneli arrin në përfundimin se OE i rekomanduar nuk ka dëshmuar përmbushjen e kërkesës së pershtatshmerisë profesionale të kërkuar nga e AK-se, për rrjedhojë oferta e tij nuk mund të konsiderohet ofertë e përgjegjshmesipas kuptimit të nenit 59 të Ligjit për Prokurimin Publik. Për pasojë, Paneli vlerëson se mosrespektimi i kërkesave të parashtruara në DT përbën shkelje të dispozitave të neneve 7, 56, 59 dhe 60 të Ligjit për Prokurimin Publik, si dhe të nenit 40 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik”**.

Nëse AK ka pasur për qëllim të lejoj pjesëmarrjen e brokerëve apo ndërmjetësuesve të sigurimeve, atëherë ka qenë obligim i AK që këtë ta specifikojë qartë dhe shprehimisht në dosjen e tenderit. AK nuk mund ta ndryshojë kuptimin e kriterit pas hapjes së ofertave dhe të relativizojë dallimin esencial ndërmjet kompanisë së sigurimit dhe brokerit vetëm për të favorizuar operatorin ekonomik të rekomanduar.

Gjithashtu kemi bërë hulumtimet në lidhje me këto kriter, ku kemi gjetur se paku 3 raste, ku Link Insurance Broker është eliminuar shkak i këtij kriteri:

Aktiviteti I Prokurimit me titull: Sigurimi I Automjeteve te ndermarrjes Ambienti per njesit Peje Kline Istog, me nr. prokurimi: KRM-25-1722-2-2-1, eshte eliminuar Link Insurance Broker. (dosjen e bashkangjitur ne sistem)

Aktiviteti I Prokurimit me titull: Sigurimi I Automjeteve me gjithsej 9 cope, me nr. te prokurimit: 213/27700-26-1968-2-3-6, eshte eliminuar Link Insurance Broker(dosjen e bashkangjitur ne sistem)

. Aktiviteti I Prokurimit me titull: Sigurimi I Automjeteve te NP Termokos, me nr. te prokurimit: NP Termokos.sha-25-7348-2-3-6, eshte eliminuar Link Insurance Broker(dosjen e bashkangjitur ne sistem)

Rrjedhimisht, konsiderojmë se operatori ekonomik i rekomanduar nuk i plotëson kriteret profesionale/licencuese të përcaktuara nga vetë Autoriteti Kontraktues dhe për këtë arsye kërkujmë anulimin e vendimit për rekomandim dhe rivlerësimin e ofertave në përputhje me kriteret e dosjes së tenderit.

Paravesisht vendimit te OSHP-se ku kategorikisht thot qe OE I rekomanduar nuk ka deshmuar permbushjen e kerkeses se pershtatshmerise profesionale te kerkuara nga AK oferta e tij nuk mund te konsiderohet e pergjegjshme, AK prap me daten 29.07.2026 pas rivlersimit te ofertave e ka shpallur fitues OE Link Insurance Broker.

Në të gjitha fushat ekonomike dhe juridike ekziston dallim ndërmjet subjektit që ofron shërbimin dhe subjektit që ndërmjetëson ofrimin e tij. Vetë përdorimi i termit "ndërmjetësim" nënkupton se shërbimi përfundimtar ofrohet nga një subjekt tjetër. Për këtë arsye, një licencë për ndërmjetësim nuk mund të konsiderohet automatikisht e barasvlershme me një licencë për ofrimin e shërbimit, përveç nëse kjo është parashikuar shprehimisht në dokumentet e tenderit ose në ligjin përkatës.(te bashkangjitur ne dosjen e dorezuar nga ana e jone I gjeni edhe Licencat per aprovim nga BQK per ofrimin e sherbimeve per produktet jo jete, gje te cilen nuk e kane kompanin e brokerimit).

Në Vendimin për refuzimin e kërkesës sonë për rishqyrtim, vërehet se Autoriteti Kontraktues ka devijuar nga objekti i pretendimeve ankimore. Në vend që të argumentojë ligjshmërinë e vendimit të tij në raport me kërkesat e Dokumentit të Tenderit dhe dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, Autoriteti Kontraktues është fokusuar pothuajse tërësisht në arsyetimin e statusit dhe licencimit të brokerit sipas Ligjit për Sigurimet. Madje, edhe dispozitat e këtij ligji janë interpretuar në mënyrë selektive, duke iu referuar vetëm pjesëve që i shkojnë në favor qëndrimit të Autoritetit, ndërsa janë anashkaluar dispozita të tjera relevante. AK, I thirret Neni 110 te Ligji per Sigurime duke e deformuar ne “brokleri eshte subjekt juridik i licencuar ne BQK per ushtrimin e veprimtarise se ndermjetesimit ne sigurime, duke vepruar ne interes te te siguruarit per prezantimin, propozimin dhe realizimin e aktiviteve qe cojne deri ne lidhjen e kontrates se sigurimit si dhe duke ofruar asistence gjate periudhes se vlefshmerise se saj”, ndersa Neni 110 sakt thote:

Neni 110 Ndërmjetësuesit në Sigurime

1. Ndërmjetësues në sigurime është personi fizik apo juridik i kontraktuar nga siguruesi dhe i licencuar nga BQK-ja, për të ushtruar veprimtari të ndërmjetësimit të sigurimeve, në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni.

2. Ndërmjetësimi në sigurime është veprimtaria e prezantimit, propozimit dhe kryerjes së aktiviteteve të tjera përgatitore, deri në nënshkrimin e kontratës së sigurimit, si dhe dhënien e asistencës gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës, veçanërisht në rast dëmi. Ndërmjetësuesit në sigurime ndahen në dy kategori, varësisht nga fakti nëse ata veprojnë kryesisht në llogari të siguruesve apo në llogari të të siguruarve:

2.1. kur ndërmjetësuesi vepron kryesisht në llogari të siguruesve, ata njihen si agjentë;

2.2. kur ndërmjetësi vepron kryesisht në llogari të të siguruarve, ata njihen si broker dhe janë të pavarur nga siguruesit, produktet e të cilëve i shet.

Pika 2. që I thirret Autoriteti Kontraktues nuk e sqaron definicionit e brokerit por termin "Ndërmjetësim", ndërsa pika 1. flet për "ndërmjetësuesin".

AK në vendimin e refuzimit të kërkesës sone për rishqyrtim leshohet edhe në një teori në lidhje me risiguresit. Ky arsyetim I AK nuk përmban asnjë relevance të ankesës sone. Në jemi duke bërë ankesën tone në lidhje me kriterin e AK në dosje të tenderit, ky merr shembuj të risiguresit.

Gjithashtu AK thotë që ka kërkuar si dokument shtesë edhe policën e përgjegjesisë profesionale, të cilën e barazpeshon me vlerën e licencës së produkteve të kompanisë së sigurimeve. AK edhe në këtë rast, me mirë do të ishte të I kerkonte OE nëse posedon ndonjë autorizim nga ndonjë kompani e sigurimeve për pjesëmarrje në aktivitetet të prokurimit sic e kërkon Ligji për Sigurime.

Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktues nuk u është përgjigjur pretendimeve tona konkrete lidhur me shkeljet e Ligjit për Prokurimin Publik dhe kriteret e përcaktuara në Dokumentin e Tenderit.

Argumente tjera shtesë pas vendimit mbi kërkesën për rishqyrtim:

Autoriteti e ngatërron licencimin me përmbushjen e kriterit të tenderit, argumenti I tyre është: "Ligji për Sigurimet lejon brokerët të ndërmjetësojnë në sigurime, prandaj ata mund të marrin pjesë në tender.", ky argument nuk I përgjigjet pretendimit tone, pretendimi jone ka qenë se "'Dokumenti i tenderit nuk kërkonte licencë për ndërmjetësim, por licencë si kompani për ofrimin e shërbimeve të sigurimeve.", keto janë dy qeshtje të ndryshme.

Autoriteti Kontraktues nuk ka arsyetuar se si licenca për ushtrimin e veprimtarisë së ndërmjetësimit është bërë e barasvlershme me licencën për ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit, megjithëse vetë dosja e tenderit nuk e parashihte një ekuivalencë të tillë.

Autoriteti Kontraktues në një pjesë të vendimit për refuzim tregon se si kompanitë e sigurimeve bashkëpunojnë me broker të ndryshëm, por fakti që kompanitë e sigurimeve bashkëpunojnë me brokerët nuk e ndryshon natyrën juridike të brokerit dhe nuk e shndërron licencën për ndërmjetësim në licencë për ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit.

Pastaj Autoriteti Kontraktues thote qe nuk ekziston asnje baze ligjore qe ndalon Autoritetin Kontraktues te lidhe kontrate me broker. Ne si OE ankues nuk pretendojme se Ligji për Sigurimet ndalon lidhjen e kontratave me brokerët. Pretendimi është se në këtë procedurë konkrete Autoriteti Kontraktues nuk ka kërkuar licencë për ndërmjetësim, por ka kërkuar licencë si kompani për ofrimin e shërbimeve të sigurimeve. Prandaj, çështja nuk lidhet me lejueshmërinë e brokerëve sipas Ligjit për Sigurimet, por me respektimin e kriterëve të LPP që vetë Autoriteti Kontraktues ka vendosur në dokumentet e tenderit.

AK thotë se brokeri "ndërmjetëson realizimin e shërbimit", ne kete sqarim vet AK pranon qe brokeri nuk eshte ai qe e ofron realizimin e shërbimit. Realizimin e ben kompania e sigurimeve dhe ky eshte nje dallim shume i rendesishem.

Autoriteti Kontraktues gjatë gjithë arsytimit të tij argumenton se brokeri është i licencuar për **ndërmjetësim në sigurime**, ndërsa nuk jep asnjë argument juridik se si licenca për ndërmjetësim bëhet licencë për **ofrimin e shërbimeve të sigurimeve**, siç është kërkuar shprehimisht në Dokumentin e Tenderit. Në fakt, vetë Autoriteti Kontraktues pranon se brokeri: ndërmjetëson realizimin e shërbimit;

- përdor produktet e kompanive të sigurimeve;
- nuk merr përsipër rrezikun e sigurimit;
- nuk lëshon policë në emrin e tij.

Këto elemente dëshmojnë se brokeri nuk është ofruesi i drejtpërdrejtë i shërbimit të sigurimit, por vetëm ndërmjetësues në realizimin e tij. Nëse Autoriteti Kontraktues konsideron se edhe brokerët e plotësojnë kriterin "kompani për ofrimin e shërbimeve të sigurimeve", pse nuk e ka shkruar këtë qartë në dosjen e tenderit? Çfarë e pengonte AK-në të përcaktonte shprehimisht se lejohen edhe brokerët e licencuar nga BQK?

Nje fakt tjeter shume me rendesi qe duhet te permendet eshte se Autoriteti Kontraktues në vendimin e tij nuk jep asnjë arsyetim juridik se përse është larguar nga konstatimet e Panelit Shqyrtues të OSHP-së, i cili ka vlerësuar se OE i rekomanduar nuk ka dëshmuar përmbushjen e kriterit të përshtatshmërisë profesionale dhe se oferta e tij nuk mund të konsiderohet ofertë e përgjegjshme sipas nenit 59 të LPP-së. Në mungesë të fakteve ose provave të reja, rivlerësimi nuk mund të shërbejë për të arritur të njëjtin rezultat duke u mbështetur në një interpretim të ndryshëm të të njëjtit kriter. Si e justifikon Autoriteti Kontraktues faktin që pas rivlerësimit shpalli përsëri fitues të njëjtin operator ekonomik, megjithëse OSHP kishte konstatuar se ai nuk kishte dëshmuar përmbushjen e kriterit të përshtatshmërisë profesionale?. Gjithashtu nuk e arsyeton vendimin e Panelit shqyrtues, ku PSH vlereson se mosrespektimi i kërkesave të parashtruara në DT përbën shkelje të dispozitave të neneve 7, 56, 59 dhe 60 të Ligjit për Prokurimin Publik, si dhe të nenit 40 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Pastaj ne kerkesen tone per rishqyrtim ju kemi drejtuar Autoriteti Kontraktues edhe me disa pyetje/prendime per te cilat Autoriteti Kontraktues nuk u pergjigjet shumicen e pretendimeve tona, por jep arsytetime te pergjithshme per rolin e brokerit duke paraqitur mungese te arsytimit dhe mosshqyrtim te plote te pretendimeve, psh.:

1. Nëse dosja e tenderit nuk e përmend brokerin, mbi çfarë baze juridike AK e zgjeroi kriterin pas hapjes së ofertave për të përfshirë edhe brokerët?,
2. Si e justifikon AK faktin që pas rivlerësimit shpalli përsëri fitues të njëjtin operator ekonomik, megjithëse OSHP kishte konstatuar se ai nuk kishte dëshmuar përmbushjen e kriterit të përshtatshmërisë profesionale?
3. A ka paraqitur OE ndonjë kontratë ose autorizim nga një kompani sigurimi që e autorizon të ofertojë në këtë aktivitet të prokurimit?
4. Në cilat tarifa të sigurimit TPL është bazuar Link Insurance Broker?
5. A ka marrë Link Insurance Broker autorizim nga ndonjë kompani sigurimi për të përdorur tarifat e saj në këtë procedurë?
5. Në lidhje me automjetin Case580 ST, ku vetëm 3 kompani kanë tarifen e cmimit 59.00€, si ka arritur brokeri të ofertojë pikërisht këtë tarifë dhe nga cili sigurues e ka marrë atë?
6. Nëse kemi paraqitur disa raste ku i njëjti broker është eliminuar për të njëjtin kriter. Pse në këtë procedurë është pranuar, ndërsa në procedura të tjera është eliminuar për të njëjtën arsye?
7. Nëse kemi paraqitur Licencën nga BQK për produktet, shërbimet e të cilave mund të ofrojnë, ku kemi sqaruar se kjo është licenca që vërteton se jemi të licencuar nga BQK për këto produkte, licence të cilën nuk e ka brokeri. Nuk kemi pranuar ndonjë argument në lidhje me këtë qeshtje.

Autoriteti Kontraktues në fund të vendimit thekson se "vlerësimi i përmbushjes së kërkesave të Dosjes së Tenderit mbetet kompetencë e Autoritetit Kontraktues". Nëse nuk e kontestojmë këtë kompetencë, pasi është e padiskutueshme se vlerësimi i ofertave i takon Autoritetit Kontraktues.

Megjithatë, kjo kompetencë nuk është diskrecionale dhe nuk mund të ushtrohet në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara nga vetë Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit. Kompetenca për të vlerësuar ofertat nënkupton detyrimin për të verifikuar nëse operatorët ekonomikë i përmbushin kriteret e shpallura, e jo të ndryshohet, zgjerohet apo riinterpretohet përmbajtja e këtyre kriterëve pas hapjes së ofertave.

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues nuk është kufizuar vetëm në vlerësimin e përmbushjes së kriterit, por ka ndryshuar përmbajtjen e tij, duke e trajtuar licencën për ndërmjetësim në sigurime si të barasvlershme me licencën për ofrimin e shërbimeve të sigurimeve, ndonëse një ekuivalencë e tillë nuk është paraparë në Dosjen e Tenderit.

Për më tepër, vetë Organi Shqyrtues i Prokurimit, në vendimin e tij, ka konstatuar se kërkesat e Dosjes së Tenderit janë obligative si për operatorët ekonomikë, ashtu edhe për Autoritetin Kontraktues, dhe se ato nuk mund të ndryshohen apo zgjerohen gjatë fazës së vlerësimit. Për rrjedhojë, kompetenca e Autoritetit Kontraktues për të vlerësuar ofertat nuk mund të shërbejë si bazë ligjore për të devijuar nga kriteret që ai vetë i ka përcaktuar.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe

nenit 40 të RRPP Nr.001/2022, kurse njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, ndërsa paragrafi 1 i neni 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Po ashtu paragrafi 6 i neni 7 të LPP-së e parasheh që “Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse”,

Po ashtu, autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga AK që të merr:

VENDIM

APROVOHET ankesa e **OE “KOMPANIA E SIGURIMEVE PRISIG SH.A”** si e bazuar,

ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM**,

DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Deme ne emer te fitimit te humbur dhe demtim te reputacionit ne tregun e sigurimeve

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*